

VENDIM
Nr. 465, datë 30.7.2021

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA “PORTI DETAR VLORE” SHA TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE TRANSFERIMIN NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE, TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË ZONËN KADASTRALE NR. 8602, BASHKIA VLORE, VËNIEN E TYRE NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “MARINA DI VALONA”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 586, DATË 10.9.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga shoqëria “Porti detar Vlorë” sh.a. te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS), të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8602, Bashkia Vlorë, sipas listës së pasurive dhe planit të rievimit, sipas aneksit I, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuritë e paluajtshme shtetërore, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, të vihen në dispozicion për zhvillimin e realizimin e projektit investues strategjik “Marina di Valona”, me subjekt investues bashkimin e shoqërive (JV) “Marina di Valona” sh.p.k., me NUIS: M01324008A, “Brunes” sh.p.k., me NUIS: K37125203H, “Ndregjoni” sh.p.k., me NUIS: K31329048I dhe “Marina Projects” LTD, me numër regjistrimi 04182366.

3. Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Marina di Valona”, bëhet për 20 (njëzet) vjet, me tarifën simbolike 1 euro/kontrata. Afati i përdorimit fillon nga data e nënshkrimit të kontratës së qirasë ndërmjet ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit investues.

4. E drejta e përdorimit të tokës shtetërore, me subjekt investues bashkimin e shoqërive (JV) “Marina di Valona” sh.p.k., me NUIS: M01324008A, “Brunes” sh.p.k., me NUIS: K37125203H, “Ndregjoni” sh.p.k., me NUIS: K31329048I, dhe “Marina Projects” LTD, me numër regjistrimi 04182366, dhe detyrimet e kushtet e përdorimit të bazohen në vendimin nr. 4/3, datë 29.3.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike dhe kontratën e qirasë që do të nënshkruhet ndërmjet subjektit investues dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

5. Pasuritë e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, hiqen nga lista e inventarit të pronave shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 586, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listave të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror”, të ndryshuar.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Porti Detar Vlorë sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLANI I RILEVIMIT TË PRONËS

